



## **Guida e Përdorimit të Platformes Virtuale të Grave në Vendimmarrje**

Mirësevini në Platformën Virtuale të Grave Shqiptare në Vendimmarrje, nëpërmjet këtij portali dhe të gjithë iniciativës që kemi ndërmarrë, kemi synuar të japim një kontribut konkret për forcimin dhe rritjen e pjesëmarrjes të femrave në të gjitha proceset sociale dhe në strukturat vendimmarrëse shqiptare duke u krijuar atyre shanse për informim më të mirë, për pjesëmarrje më të lartë dhe cilësore në proceset vendimmarrëse si dhe për mbështetjen e barazisë gjinore, qoftë në vendimmarrje e në politikë, qoftë në fushat kyçe të zhvillimit të gruas në Shqipëri.

Portali do të përmbajë statistikën mbi gratë shqiptare në politikë vendimmarrje dhe informacione bazë dhe më pas do të jetë kontributi ynë i përbashkët me informacione, statistika, publikime, problematika, etj, që do ta bëjnë këtë portal një pikë takimi e të gjithë qytetarëve, organizmave të përfshirë në çështjet e barazisë gjinore si privatë ashtu edhe publikë dhe i çdo pale të interesuar për të qënë në kontakt të vazhdueshëm e të drejtëpërdrejtë me gratë shqiptare dhe të vetë atyre me njëra tjetrën, brenda edhe jashtë Shqipërisë.

Per te qene sa me afer cdo qytetari qe ka dëshire te marre apo te jape informacion nepermjet platforms, jemi munduar të ruajmë thjeshtësinë dhe lehtësinë në përdorimin e portalit.

Në vijim do të gjeni një shpjegim të thjeshtë dhe praktik mbi përdorimin e formave tona për shtimin e statistikave dhe informacioneve të ndryshme në portal nga vetë ju.

### **1. Për të shtuar një statistikë të re ose më të përditësuar:**

Në çdo faqe mbi statistikën mund të gjeni butonin “SHTO STATISTIKË”:

**Nese dëshironi te publikoni ne kete portal nje statistike tjeter, ju lutem klikoni ne vijim.**

**SHTO STATISTIKA**

*Shënim: Statistika e njoftuar mund të jetë mbledhur në vijë të parës në lartësi të koordinatave të kësaj iniciative nga të gjithë qytetarët dhe bashkëpunimi me institucionet përkatëse. Lëvizja për çështjet e qytetit përfshijet për të siguruar një informacion të saktë, i cili është i përbashkët, i bashkëpunues dhe i përbashkët. Për çdo pyetje të qytetarëve, ju lutem të na informoni, që të propozojmë mënyra më të përshtatshme përkatëse. Rrjeti i Grave Barazi në Vendimmarrje, e ka realizuar këtë portal për informim të përgjithshëm të publikut dhe nuk mban përgjegjësi për ndonjë pasqyrim të informacionit statistikor të publikuar.*

që do t'ju çojë në faqen për të plotësuar formën:



**Forma:**

**Identifikohu**

**Emri:**  
 (\*) ← Këtu duhet emri juaj

**Email:**  
 (\*) ← Emaili juaj për kontakt

**Permbajtja**

**Titulli:**  
 ← Këtu mund të shkruani emrin e institucionit

**Teksti (\*):**  
 ← Statistikat që doni të publikoni

**Burimi i informacionit:**  
 ← Emërtimi i Institucionit ose Linku i faqes ku ndodhet informacioni.

**Pyetje Sigurie:**  
**Ne cilin vit jemi (shifra)?**  
 ← Kjo është një pyetje sigurie për të parandaluar spam-et. Këtu duhet të shkruani "2012".


**Dergo** ← Klikoni mbi butonin "Dërgo" për ta ruajtur.

Pasi ta keni dërguar, do të merrni një mesazh konfirmimi që statistikat tuaja janë ruajtur dhe do të shfaqen në Portal sapo të miratohen nga Administratori.



## 2. Për të shtuar një publikim:

Klikoni mbi menunë “Publikime” dhe në fund të faqes do të gjeni butoni “SHTO PUBLIKIM”:



që do t’ju çojë në faqen për të plotësuar formën.



**Identifikohu**

**Fmri:**  
 (\*) ← Këtu duhet emri juaj

**Email:**  
 (\*) ← Emaili juaj për kontakt

**Pembajtja**

**Titulli:**  
 ← Këtu mund të shkruani emrin e publikimit

**Teksti (\*):**  
 ← Një tekst përshkues

**Ngarko dokument**

Maksimumi për të ngarkuar: 1 MB  
Llojet e lejuara: .doc .pdf

Zgjidh:  No file chosen

← Këtu mund të ngarkoni dokumentin tuaj në format pdf ose word.

**Eurimi i informacionit:**  
 ← Emërtimi i Institucionit ose Linku i faqes ku ndodhet informacioni.

**Pyetje Sigurie:**  
**Në cilin vler jemi (shifra)?**  
 ← Kjo është një pyetje sigurie për të parandaluar spam. Et këtu duhet të shkruani "2012".

← Klikoni mbi butonin "Dergo" për ta ruajtur.

Pasi ta keni dërguar, do të merrni një mesazh konfirmimi që publikimi juaj është ruajtur dhe do të shfaqet në Portal sapo të miratohet nga Administratori.



**3. Për çdo kategori nga menuja “Media” do të gjeni, në fund të faqes, një buton që do t’ju çojë në formën për kategorinë përkatëse.**

Në çdo formë do të gjeni fushat:

- a) Emri: Këtë fushë do ta plotësoni me emrin tuaj.
- b) Email: Këtë fushë do ta plotësoni me emailin tuaj.
- c) Titulli: Këtë fushë do ta plotësoni me një titull.
- d) Teksti: Këtu do të shkruani përmbajtjen e materialit tuaj.
- e) Ngarkoni një dokument: Këtu mund të ngarkoni një foto.
- f) Burimi i Informacionit: Këtu do të vendosni emërtimin e institucionit ose linkun e faqes ku ndodhet informacioni. Kjo fushe eshte shume e rëndesishme pasi para se te publikohet korrektesia dhe vertetesia e informacionit do te konfirmohet nga administratori.
- g) Pyetje Sigurie: Kjo fushë është për arsye sigurie të faqes, këtu duhet të shkruani vitin aktual psh. “2012”.
- h) Më pas duhet të klikoni “Dërgo” që postimi juaj të ruhet.

Pasi ta keni dërguar, do të merrni një mesazh konfirmimi që postimi juaj është ruajtur dhe do të shfaqet në Portal sapo të miratohet nga Administratori.

**4. Nëse jeni duke organizuar ose jeni në dijeni të një aktiviteti dhe dëshironi t’ja bëni të ditur një mase të gjerë njerëzish, ju ftojmë ta publikoni atë në portalin tonë, nën menunë “Iniciativa”, sipas kategorisë përkatëse, nëse është aktivitet, do të gjeni një buton “SHTO AKTIVITET” në fund të faqes së aktiviteteve dhe gjithashtu, nëse është një lajmërim, do të gjeni një buton “SHTO LAJMERIM” në fund të faqes së lajmërimeve.**

Në çdo formë do të gjeni fushat:

- i) Emri: Këtë fushë do ta plotësoni me emrin tuaj.
- j) Email: Këtë fushë do ta plotësoni me emailin tuaj.
- k) Titulli: Këtë fushë do ta plotësoni me një titull.
- l) Teksti: Këtu do të shkruani përmbajtjen e materialit tuaj.
- m) Burimi i Informacionit: Këtu do të vendosni emërtimin e institucionit ose linkun e faqes ku ndodhet informacioni. Kjo fushe eshte shume e rëndesishme pasi para se te



publikohet korrektesia dhe vertetesia e informacionit do te konfirmohet nga administratori.

- n) Pyetje Sigurie: Kjo fushë është për arsye sigurie të faqes, këtu duhet të shkruani vitin “2012”.
- o) Më pas duhet të klikoni “Dërgo” që postimi juaj të ruhet.

Pasi ta keni dërguar, do të merrni një mesazh konfirmimi që postimi juaj është ruajtur dhe do të shfaqet në Portal sapo të miratohet nga Administratori.